

LIRIA - GËZIMI I



NJERËZIMIT

PJESËT KRYESORE TË DEMOKRACISË

ENDRIT (10), NORA (11), ENKELA (10), ORSA (10), LEONA (10), RILIND (10), SHKURTA (10)



Demokracia ka disa elemente që duhet t'i respektojmë siç janë: votimet, liria, respekti dhe toleranca, ligje të barabarta për të gjithë, zgjedhja e profesionit, etj

Në Kosovë ka demokraci. Pra, kjo është gjë e mirë sepse kemi dhe të drejtat për zgjedhje. Fjala demokracia rrjedh nga greqishtja, sepse në Greqi është përdorur demokracia për herë të parë, në vitin 507 p.e.s. Çfarë kuptojmë me fjalën demokraci? Me fjalën demokraci kuptojmë pushtetin e popullit. Gjëja më kryesore në demokraci është liria. Në Kosovë ne kemi pavarësinë që para 8 vitesh. Vetë fjala liri tregon lirinë

gazetarinë e shumë profesione tjera, i zgjedhim vet ne si njerëz të lirë. Votimet janë për të zgjedhur kryetarin e klasës, kryetarin e shkollës, kryetarin e kuvendit, etj. Votimet i bëjmë për ta bërë jetën tonë më të mirë. Nëse ne mendojmë se ai/ajo do ta bëjë vendin tonë më të mirë ne e votojmë atë. Nxënësit në shkollë votojnë se cili vizaton më mirë, se cili këndon më mirë, etj. Ne kemi shumë të drejta. Ato do t'i shkruajmë ë vazhdim: kemi të drejtën e lojës dhe argëtimit, kemi të drejtën e lirisë dhe zgjedhjes së punës, kemi të drejtën e ushqimit dhe veshmbathjes Kemi të drejtën e shkollimit, kemi të drejtën të kemi shokë ose shoqe.



Vetë fjala respekt tregon se çdo rregull duhet respektuar nga çdo moshë apo gjini. Rregullat ndahen në grupe apo role ku ne bëjmë pjesë. Rregullat dallojnë nga vendi se ku jemi. Në shkollë duhet respektuar rregulli i nxënësve, në shtëpi duhet respektuar rregulli i fëmijëve, në dyqan duhet respektuar rregulli i blerësve, etj. Respektimi i rregullave duhet t'i kushtohet punës dhe obligimit qytetar.

e personit. Ne duhet të jemi të lirë, për shembull të dalim me familjen tonë. Nuk ka dallim raca apo gjinia në Kosovë, çdo fëmijë apo i rritur ka të drejtën e lirisë. I lirë për të luajtur, i lirë për tu argëtuar etj. Liria është gëzimi i njerëzimit. Ne si fëmijë mund të zgjedhim profesionin që mund ta ushtrojmë. Zgjedhjen e bëjmë vet! Ne të cilët i kemi trashëgimi nga familja ose breza të tjerë mund ta marrim një profesion të caktuar. P.sh. ne të cilët kemi trashëgimi artin mund të bëhemi piktorë. Çdo profesion si: pikturën, aktrimin, sportin,



Më të mirët

TË GJITHË DUHET TË JEMI QYTETARË AKTIV

AGNESA (10), BUJAR (10), ORNELA (10), ARISA (10), DIANA (11), ARDIAN (10), DONART (10)

Për te mirën e vendit tonë të gjithë ne duhet të jemi qytetarë aktiv, të marrim pjesë në organizata dhe shoqata të ndryshme


Ne jemi qytetarë të Kosovës sepse qytetar konsiderohet çdo person që jeton brenda një shteti të caktuar. Prandaj, ne si qytetarë kemi të drejta dhe përgjegjësi. Disa nga të drejtat tona janë: të shkollohemi, të luajmë, të shprehim atë që mendojmë, të lëvizim lirshëm, etj. Disa nga përgjegjësitë tona janë: të respektojmë ligjin, ta pastrojmë ambientin dhe ta ruajmë atë, ta respektojmë njëri-tjetrin, etj. Ne si qytetarë aktiv duhet të pastrojmë lagjen, shkollën dhe të jemi aktiv në vendin tonë. Ne i porosisim të tjerët: që të jesh qytetar i mirë atëherë duhet të jesh sa më aktiv, të dalësh në zgjedhje, të mësosh shumë etj. Në të ardhmen, ne do të jemi shumë të rëndësishëm për vendin tonë prandaj jemi të përgjegjshëm që tani.



Qershitë e artikullit



Ne kemi të drejtën e lojës dhe argëtimit



Përgjegjësi e jona është të respektojmë ligjin



Qytetari aktiv duhet të dal në zgjedhje



Ambienti i pastër është përgjegjësi e jona

VOTA JONË KA VLERË

RON (11), ENES (10), ELSA (10), ERA (10), SHEHIDE (10), ERINA (10)


Ne si ardhmja e vendit tonë, mësuam për procesin zgjedhor në Republikën e Kosovës

Vota jonë ka vlerë sepse ajo mund të bëjë ndryshime. Populli e ka fuqinë, sepse ai vet vendos për të ardhmen e tij. Përmes zgjedhjeve i zgjedhim përfaqësuesit e shtetit tonë. Ne kemi të drejtë vote nga moshja 18 vjeçare. Zgjedhjet janë një element i rëndësishëm për shtetin tonë demokratik. Kemi dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhje parlamentare ku zgjedhen deputetët dhe zgjedhjet komunale ku zgjedhen kryetarët e komunave. Kuvendi i Kosovës ka 120 deputetë, 20 prej tyre janë nga komunitetet jo shumicë.


Kjo nënkupton se vota jonë ka rëndësi të madhe sepse ndikon në zgjedhjen e përfaqësuesve të mirë të vendit dhe përmes votimit ne e shprehim mendimin tonë lirshëm dhe pa imponime.




Votuesit e së ardhmes



Demokracia është ndriçim për ne



Vota jonë mund të bëjë ndryshim



Në moshën 18 vjeçare kemi të drejtë vote



Votimi bëhet në mënyrë të fshehur

NDARJA E PUSHTETIT NË KOSOVË

ERON (10), ERZAN (10), RITA (10), BEHARE (10), ERIDA (10), VLERA (10)



Ne sot kemi shkruar për mënyrën se si ndahet pushteti në Republikën e Kosovës

Në një vend demokratik, pushteti ndahet në tri pjesë, e ato janë: Pushteti Legjislativ, Pushteti Ekzekutiv dhe Pushteti Gjyqësor.

Pushteti Legjislativ, ushtrohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Në Kuvend bëjnë pjesë 120 deputetë. Gjithashtu, në Kuvend bën pjesë edhe Kryetari i Kuvendit, zv. Kryetari etj. Kuvendi i Kosovës kryen këto funksione e ato janë: përfaqëson shtetin dhe popullin, miraton, shfuqizon dhe propozon ligje, mbikëqyr punën e Qeverisë, zgjedh Qeverinë dhe Presidentin.

Pushteti ekzekutiv ushtrohet nga Qeveria. Në Qeveri bëjnë pjesë Kryeministri i cili e udhëheq Qeverinë, ministrat (i shëndetësisë, i bujqësisë, i arsimit, e kulturës, rinisë dhe sportit, i infrastrukturës dhe mjedisit) etj.


Pushteti gjyqësor ushtrohet nga gjykatat. Gjykatat ndahen në tri gjykata: Gjykata Themelore, e cila merret me probleme më të vogla; Gjykata e Apelit, e cila merret me problemet pak më të mëdha se Gjykata Themelore; dhe Gjykata Supreme, e cila merret me probleme më të mëdha si p.sh. me krime të organizuara, me vrasje etj.

Kjo ndarje e pushtetit bëhet për arsye se më mirë kryhen punët nëse të gjithë i ndajnë detyrat e tyre. Edhe pse këto pushtete janë të ndara, ato vazhdimisht punojnë së bashku me njëra-tjetrën.

Faleminderit që e gjetët kohë ta lexoni artikullin tonë.



Sot jemi gazetarë të Kuvendit të Kosovës



Mënyra e ndarjes së pushtetit



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Pjetër Bogdani“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-2
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë